

## **Inspektime në disa objekte publike në Gjirokastrë, vlerësim i nivelit të përshtatshmërisë dhe propozime mbi arritjen e nivelit bazë të përshtatshmërisë së tyre.**

Qyteti i Gjirokastrës përbëhet nga Qyteti i Vjetër, me kalanë e cila është bërthama e parë e vendbanimit, lagjet tradicionale që shtrihen në formë rrezesh rreth kalasë dhe lagjet e reja ku ndodhen ndërtimet bashkëkohore dhe kompleksi universitar.

Si një qytet me vlera arkitektonike dhe pjesë e trashëgimisë kulturore botërore, bëhet e vështirë ndërhyrja për përshtatjen e tyre për përdorim nga PAK pa i cënuar ato, veçanërisht në objektet e kategorisë së parë. Ndërtimi i qytetit në terren malor dhe me shumë disnivele e vështirëson gjithashtu ndërhyrjen për vendosjen e elementëve të përshtatshmërisë/rampave sipas standarteve. Gjithsesi në objektet e institucioneve ku ofrohet pjesa më e madhe e shërbimeve me frekuentim më të lartë nga publiku dhe aty ku është e mundur, do të duhet të ndërhyhet për të arritur një nivel bazë përshtatshmërie për të siguruar aksesin nga PAK në shërbimet kryesore, sipas VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 *“Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”*.

Nga takimi i zhvilluar me Zv/Kryetaren e Bashkisë, u sigurua informacioni mbi objektet me të frekuentuara nga publiku dhe situatën e tyre si edhe lista me objektet që do të inspektoheshin dhe vlerësoheshin mbi nivelin e përshtatshmërisë së tyre. Inspektimi i objekteve të rekomanduara nga Bashkia u krye së bashku me një përfaqësuese të bashkisë e cila ndihmoi për lehtësimin e aksesit në objekte dhe kryerjen e matjeve të elementëve për vlerësimin e nivelit ekzistuese të përshtatshmërisë së tyre. Mbas analizës u propozuan përmirësime për arritjen e nivelit bazë të përshtatshmërisë dhe ku ishte e mundur, në objektet publike si më poshtë:

**Godina e bashkisë:** është ndërtesë 3 kat e pozicionuar në qendrën muzeale të qytetit dhe e vendosur në një kodër me disnivele shumë të lartë nga rruga publike.



Godina kryesore e bashkisë

Nga informacioni i siguruar në bashki rezulton që në këtë godinë kryen funksionet kryesisht stafi drejtues i institucionit, ndërkohë që shërbimet kryesore më të frekuentuara për publikun ofrohen në mjedise jashtë kësaj ndërtese, në katin përdhe të një ndërtese ku është i siguruar aksesin për PAK.

Hyrja kryesore në godinën e bashkisë arrihet me një numër të konsiderueshëm shkallësh monumentale prej guri, krejtësisht të pa përshtatura për përdorim nga PAK. Disnivele shumë të madhe dhe trajtimi arkitektonik i shkallëve që aksesojnë godinën e Bashkisë nga rruga kryesore, nuk lejojnë aksesin në këtë objekt me anë të rampave dhe/ose të një platforme ngritëse vertikale.

**Shkolla e mesme/gjimnazi "Siri Shaplllo"** është një ndërtesë 3 kat e rikonstruktuar dhe e mirëmbajtur.

**Gjetje dhe rekomandime për aksesin në hyrje dhe nivelin bazë të përshtatshmërisë së objektit:** Hyrja kryesore e shkollës arrihet me 6 bazamakë shkallësh të jashtme 15cm x 30cm. Përbri saj është vendosur një plan i pjerrët për të lehtësuar aksesin për nxënësit PAK që lëvizin me karrigen më rrota. Rampa ka gjatësi 530cm dhe gjerësi 110cm, ndërkohë që sipas standartit duhet të jetë më gjatësi 1250cm, përshi një sheshpushimi në mes të saj. Gjerësia e rampës duhet të jetë 120cm dhe rampa duhet të jetë e paisur me parmakë dhe me shirita orientues në fillim dhe mbarim të pjerrësisë për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose shikojnë me shumë vështirësi. Dera e hyrjes është me dy kanata nga 70cm dhe hapet nga brenda, ndërkohë që standarti e kërkon të hapet nga jashtë dhe të jetë lehtësisht e manovrueshme nga PAK.



Hyrja dhe rampa



Pamje e përgjithshme



Korridori

Katet e sipërme arrihen me shkallë të brendshme të përbëra nga tre rampa shkalle 3 bazamakë me 17cmx30cm + 12 bazamakë me 17cmx30cm + 4 bazamakë me 17cmx30cm.

Dyert e klasave kanë gjerësi 90cm. (plotëson standartet) dhe hapen nga brenda, ndërkohë që standarti e kërkon të hapen nga jashtë.

Korridoret kanë gjerësi 180cm. Do të ishte e nevojshme që në mes të dyshemesë së hollit dhe korridoreve të vendosen shirita orientues me degëzime në klasa dhe në grupin e

tualeteve, për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë. Në muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.

Grupi i tualeteve është i pozicionuar në fund të korridorit dhe përbëhet nga një hapësirë ku është vendosur lavomani dhe ka tre tualete me përmasa 150cm x 100cm. Në secilin prej tyre ka vetëm një WC. Dera që akseson grupin e tualeteve nga korridori, ka gjerësi 80cm, ndërsa dyert e secilit tualet kanë gjerësi 60cm. Të gjitha dyert hapen nga brenda.

Në gjendjen që janë tualetet janë krejtësisht të papërshtatura për përdorim nga PAK si nga përmasat, nga hapësira e dyrve ashtu edhe nga paisjet.

Do të rekomandonim që të krijohet një tualet i përshtatur sipas standartit, me përmasa që të sigurojnë hapësirën e lirë në mes me diametër 150cm, paisjet të jenë të varura, tualeti të jetë e paisur me sinjal alarmi me zë dhe me dritë, shtresa e dyshemesë të jetë jo rrëshqitëse.

Bankat të jenë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme dhe korridoret mes bankave të jenë sipas standarteve

Nga rikonstrukcioni i fundit i ndërtesës, dyshemeja e hollit dhe korridoreve është shtruar me pllaka të ndritëshme/rrëshqitëse, ndërkohë që rekomandohet dysheme jo rrëshqitëse në të gjitha mjediset e shkollës.

**Teatri "Zihni Sako"** është një ndërtesë 2 kat që ndodhet në zonën qendrore të qytetit në të cilën nuk është kryer asnjë rikonstrukcion prej një kohe të gjatë.

**Gjetje dhe rekomandime për aksesin në hyrje dhe nivelin bazë të përshtatshmërisë së objektit:** Hyrja kryesore e teatrit arrihet me shkallët kryesore të përbërë nga dy pjesë, njera me 3 bazamakë shkallë 15cmx35cm dhe tjetra me 6 bazamakë shkallë 15cmx35cm. si edhe nga një shkallë tjetër anësore në të djathtë të saj, të përbërë nga dy pjesë, njera me 5 bazamakë shkallë 15cm x 35cm dhe tjetra me 6 bazamakë shkallë 15cm x 35cm.



Shkalla kryesore



Shkalla anësore



Hyrja direkt në sale

Vendosja e rampës nga rruga publike përbri shkallës në hyrjen kryesore, ndonëse ajo është një shkallë shumë e gjerë, do të kërkonte një sipërfaqe të konsiderueshme.


Vendosja e rampës përbri shkallës anësore do të kërkonte sipërfaqe edhe me të madhe për shkak të numrit më të madh të shkallëve (disnivelit më të madh nga niveli i sheshit)

Biletaria e teatrit dhe hyrja në sallën e teatrit (në rrjeshtat e pare) arrihen me një shkallë anësore prej guri me 6 bazamakë 16cm x 35cm. Dera e hyrjes është me 4 kanata të hapëshme nga brenda. Kjo derë komunikon me korridorin kryesor të teatrit, ku ndodhet hyrja në sallë si edhe shkallët për tek llozha. Niveli ku është vendosur rrjeshti i parë dhe i dytë i karrigeve në sallën e cfaqjes, ku mund të vendoset lehtësisht karrigja me rrota, arrihet me dy bazamakë 17cm x 39cm. Kalimi i këtij disniveli mund të realizohet me vendosjen e një rampe portative prej druri ose metali.

Sheshpushimi i shkallës së jashtme para kësaj hyrje të teatrit, vazhdon përtej gjerësisë së shkallës dhe krijon një disnivel prej 80cm me nivelin e sheshit. Për të mos cënuar pamjen kryesore të këtij objekti, do të rekomandonim vendosjen e rampës në fund të këtij sheshpushimi, përgjatë murit të ndërtesës. Rampa duhet të ketë gjerësi të jashtme 120cm dhe gjatësi 1150cm, përfshi edhe një sheshpushimi në mes të saj. Rampa duhet të paiset me parmakë dhe korimano, si edhe me shirita orientues në fillim dhe në fund të pjerrësive. Sipërfaqja veshëse e rampës duhet të jetë jo rrëshqitëse.

**Shkolla “Koto Hoxhi”**, është një shkollat 9-vjeçare më të frekuentuara të Gjirokastrës dhe është një ndërtesë 3 kat dhe. Për shkak të situatës pas termetit kjo shkollë ishte e mbyllur dhe nuk u mundësua inspektimi i saj, por rekomandimet janë bazuar në ngjashmërinë e ndërtesës me shkollat e tjera të kësaj natyre dhe periudhe.

**Gjetje dhe rekomandime për aksesin në hyrje dhe nivelin bazë të përshtatshmërisë së objektit:** Nga jashtë arritëm të konstatojmë që shkolla ka dy hyrje. Oborri i shkollës arrihet në dy drejtime, nga dy rrugë të ndryshme. Porta kryesore ka disnivel me sheshin/terrenet sportive para hyrjes në mjediset e brendshme të shkollës, i cili kalohet me disa bazamakë shkalle zbritëse. Porta nga mbrapa akseson oborrin/terrenin sportiv me një plan të pjerrët direkt mbas portës. Të dy sheshet/terrenet sportive kanë disnivel që kalohet me 3 bazamakë shkallësh.



Pamje nga jashtë oborrit të shkollës

Për arritjen e nivelit të sheshit para hyrjes në shkollë, janë vendosur 2-3 bazamakë shkalle. Terrenet sportive janë të shtrira në të gjithë oborrin e shkollës edhe në hapësirën para hyrjes në shkollë. Gjithsesi nga jashtë vërehet që disniveleli ndërmjet rrugës dhe sheshit të shkollës nga hyrja kryesore është më i madh se disniveleli nga hyrja dytësore. Vërehet gjithashtu që hyrja për në mjediset e brendshme të shkollës arrihet me dy bazamakë prej rreth 30-35cm + 10-15cm.

Për të siguruar një akses minimalist të nxënësve PAK që lëvizin me karrigen me rrota do të rekomandonim krijimin e aksesit nga hyrja dytësore ku edhe disniveleli është më i vogël. Gjithsesi për arritjen e hyrjes për në mjediset e brendshme të shkollës duhet të vendoset një rampë me gjerësi të jashtme 120cm dhe gjatësi 500cm. Rampa duhet të paiset me parrmakë/korimano, si edhe me shirita orientues në fillim dhe në fund të pjerrësisë. Sipërfaqja veshëse e rampës duhet të jetë jo rrëshqitëse.

Për të përmirësuar nivelin e përshtatshmërisë në mjediset e brendshme të shkollës do të propozonim: Dyert e klasave të kenë gjerësi 90cm. dhe të hapen nga jashtë.

Në mes të dyshemesë së hollit dhe korridoreve të vendosen shirita orientues me degëzime në klasa dhe në grupin e tualeteve, për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose shikojnë me shumë vështirësi. Në të dy muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.

Të krijohet një tualet i përshtatur sipas standartit, me përmasa që të sigurojnë hapësirën e lirë në mes me diametër 150cm, paisjet të jenë të varura, tualeti të jetë i paisur me sinjal alarmi me zë dhe me dritë, shtresa e dyshemesë të jetë jo rrëshqitëse.

Bankat duhet të jenë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme dhe korridoret mes bankave të jenë me gjerësi sipas standarteve.

**Qendra Shëndetësore/Ambulanca më e frekuentuar e qytetit:** funksionon në katin përdhe të një ndërtese dhe ka disnivele të konsiderueshëm nga niveli i sheshit të pallatit.

**Gjetje dhe rekomandime për aksesin në hyrje dhe nivelin bazë të përshtatshmërisë së objektit:** Mjediset e brendshme të ambulancës arrihen me 6 bazamakë shkalle me përmasa 17cm x 30cm + 1 bazamak, i fundit për tek sheshpushimi prej 13cm.



Aksesi i PAK që lëvizin në karrigen me rrota, në mjediset e brendshme të ambulancës është i vështirë për shkak të shkallëve dhe mungesës së rampës. Kalimi i disniveletit prej 115cm. me vendosjen e një rampe, nuk do të ishte efikas për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme që kërkon rampa (gjatësi minimale prej 1400cm. përfshi një sheshpushimi në mes të saj) dhe sipërfaqes së kufizuar që ka hapësira në dispozicion. Një mundësi tjetër është vendosja e një platforme ngritëse pranë sheshpushimit të shkallës.

Dera e hyrjes arrihet me prag 15 cm të lartë, ndërkohë që standarti lejon prag deri në 3cm. Dera e hyrjes ka gjerësi 83cm dhe hapet nga brenda, ndërkohë që standarti kërkon që dera të hapet nga jashtë dhe të jetë lehtësisht e manovrueshme nga PAK. Vërehet që gjatë orarit të funksionimit të ambulancës, dera e hyrjes mbetet e hapur dhe nuk ka nevojë të hapet e të mbyllet nga personat që e frekuentojnë atë. Në korridorin në hyrje janë vendosur ndenjësë për pritjen e publikut. Në mes të dyshemesë së korridoreve duhet të vendosen shirita orientues për PAK që nuk shikojnë, si edhe në muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.

**Universiteti "Eqrem Cabej":** Kompleksi universitar është i pozicionuar në një terren malor me disnivelet të lartë nga rruga publike dhe përbëhet nga 3 korpuse me dy dhe tre kate. Edhe ky universitet ishte i mbyllur për shkak të tërmetit.

**Gjetje dhe rekomandime për aksesin në hyrje dhe nivelin bazë të përshtatshmërisë së objektit:** Korpusi qendror arrihet nga rruga me disa grupe shkallësh monumentale prej guri të skalitur, grupi i pari me 7 bazamakë prej 18cm x 45cm + 1 bazamakë prej 17cm x 50cm (e para); grupi i dytë me 6 bazamakë prej 18cm x 45cm (deri tek porta e hekurt). Sheshpushimi ndërmjet këtyre dy grupeve të shkallëve është me pjerrësi (nuk është horizontal). Këto dy grupe shkallësh aksesojnë portën e hekurt të sheshit para kompleksit universitar.



Hyrja kryesore



Korpusi qendror



Fakulteti i letërsi/Ekonomi

Më tej ka dy grupe me nga 8 bazamakë secili prej 18cm x 35cm, dhe në fund një grup me 9 bazamakë prej 18cm x 35cm. me të cilin arrihet në sheshin para hyrjes kryesore. Mbas këtij korpusi ndodhet korpusi 2 kat i fakultetit të shkencave/matematikës i cili

arrihet gjithashtu me një grup shkallësh. I shkëputur nga këto dy korpuse ndodhet ndërtesa 2 kat e fakultetit të gjuhë-letërsisë dhe ekonomisë.

Një mundësi tjetër për arritjen e kompleksit universitar (sheshin para portës së hekurit), është nga rruga publike në krahun e majtë të kompleksit e cila akseson direkt sheshin dhe ndërtesën para fakultetit të letërsisë dhe ekonomisë.

Hyrja në fakultetin e letërsisë dhe ekonomisë arrihet me 8 bazamakë shkalle prej 17cm x30 cm. duke krijuar një disnivel prej 144cm nga niveli i sheshit para objektit. Përbri shkallës është vendosur një rampë për arritjen e hyrjes e cila është e paisur me parmakë. Ndonëse rampa nuk i plotëson të gjitha standartet, ajo lehtëson ndjeshëm aksesin e PAK në këtë fakultet. Ndërkohë për arritjen e korpusit kryesor dhe ndërtesën e fakultetit të shkencave/matematikës nga kjo rrugë duhet të kalohen 3 bazamakë zbritje me shkallë guri 15cmx35cm, më pas një ngjitje dhe më tej 3 grupet e shkallëve me 8+8+9 bazamakë të cilat aksesojnë hyrjen kryesore në korpusin qendror të kompleksit universitar.

Disniveli shumë i madh dhe trajtimi arkitektonik i shkallëve që aksesojnë korpusin qendror nga rruga kryesore, nuk lejojnë aksesin në këtë korpus me anë të rampave.

I vështirë është aksesin e këtij korpusi edhe nga rruga dytësore e cila lejon arritjen me lehtësi të sheshit para fakultetit të letërsisë dhe ekonomisë, mbasi këto dy ndërtesa nuk kanë mundësi komunikimi në mjediset e brendshme të tyre.

Meqënëse fakulteti i letërsisë dhe ekonomisë aksesohet nga rruga nga mbrapa dhe aktualisht ka një rampë për të arritur në mjediset e katit përdhe, edhe pse rampa nuk i ka të gjithë elementët sipas standarteve, do të ishte mirë që kjo godinë të plotësohet me elementët bazë të përshtatshmërisë, fillimisht në mjediset e katit përdhe e më pas edhe në katin e sipërm duke vendosur ashensor.

Për të përmirësuar nivelin e përshtatshmërisë në mjediset e brendshme të ndërtesës do të propozonim: Në mes të dyshemesë së hollit dhe korridoreve të vendosen shirita orientues me degëzime në klasa dhe në grupin e tualeteve, për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose shikojnë me shumë vështirësi. Në të dy muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.

Të krijohet një tualet i përshtatur sipas standartit, me përmasa që të sigurojnë hapësirën e lirë në mes me diametër 150cm, paisjet të jenë të varura, tualeti të jetë i paisur me sinjal alarmi me zë dhe me dritë, shtresa e dyshemesë të jetë jo rrëshqitëse.

Bankat duhet të jenë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme të tyre dhe korridoret mes bankave të jenë me gjerësi sipas standarteve. Dyert e klasave të kenë gjerësi 90cm. dhe të hapen nga jashtë.

Jemi në dispozicion për të plotësuar çdo kërkesë.

## PLANI I MASAVE

<b>Shkolla e mesme/gjimnazi "Siri Shaplo"</b>		
<b>Zona</b>	<b>Gjetjet/Gjendja ekzistuese</b>	<b>Kërkesat për nivelin bazë të përshtatshmërisë</b>
<b>Oborri</b>	Oborri i shkollës arrihet direkt dhe lehtësisht nga rruga publike, nëpërmjet një porte hekuri. Në shtresën veshëse të oborrit mungojnë shiritat orientues për të lehtësuar aksesin e PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim	<i>Në shtresën veshëse të oborrit duhet të vendosen shirita orientues për PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim për të arritur hyrjet dhe mjediset terrenet sportive</i>
<b>Hyrja kryesore</b>	<p>Hyrja kryesore e shkollës arrihet me 6 bazamakë shkallë të jashtme 15cm x 30cm. Shtresa veshëse e shkallëve është jo rrëshqitëse.</p> <p>Përbri shkallës është vendosur një rampë për të lehtësuar aksesin për nxënësit PAK që lëvizin me karrigen më rrota. Rampa ka gjatësi 530cm dhe gjerësi 110cm. Shtresa veshëse e rampës është jo rrëshqitëse.</p> <p>Dera kryesore e hyrjes është pjesërisht e plotë dhe pjesërisht me xham, me dy kanata me gjerësi 70cm të cilat hapen nga brenda</p>	<p><i>Të vendosen parrmakë në të dy anët e shkallës dhe parrmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të shkallës në fillim e në fund të saj. Të vendosen shirita orientues në fillim dhe në fund të shkallës, si edhe shirita abrazivë në cdo bazamak të shkallës.</i></p> <p><i>Të korrigjohet rampa. Gjatësia e rampës të jetë 1250cm, përsi një sheshpushimi në mes të saj. Gjerësia e rampës duhet të jetë 120cm dhe rampa duhet të jetë e paisur me shirita orientues në fillim dhe mbarim të pjerrësisë për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim. Të vendosen parrmakë në të dy anët e rampës dhe parrmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të saj në fillim e në fund të saj.</i></p> <p><i>Dera duhet të jetë me kanata me gjerësi 85cm - 90cm lehtësisht të hapshme nga jashtë (mundësisht me hapje automatike). Në pjesët e xhamit të vendosen shenjat dalluese.</i></p>
<b>Holli &amp; Korridoret</b>	<p>Holli akseson korridoret dhe shkallët për të arritur në katet e sipërme. Nuk ka panel informues të përshtatur</p> <p>Korridoret kanë gjerësi 180cm. Gjatë rikonstruksionit të fundit të ndërtesës, dyshemeja e hollit dhe korridoreve është shtruar me pllaka të ndritëshme/rrëshqitëse,</p>	<p><i>Në holl duhet të vendoset panel informacioni i shkruar në brail dhe me drita, për PAK që nuk shikojnë si edhe PAK që nuk dëgjojnë</i></p> <p><i>Në mes të dyshemesë së hollit dhe korridoreve të vendosen shirita orientues me degëzime në klasa dhe në grupin e tualeteve, për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë. Në muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.</i></p>



<p><b>Klasat</b></p>	<p>Dyert e klasave janë të plota prej druri, me përmasa rreth 90cm dhe të hapëshme nga brenda.</p> <p>Bankat në klasat që arritëm të inspektojmë janë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme.</p> <p>Dyshemeja është jo rrëshqitëse</p>	<p><i>Dyert duhet të jenë lehtësisht të hapëshme dhe me hapje nga jashtë.</i></p> <p><i>Së paku 15% e të gjitha bankave të plotësojë standartet e përshtatshmërisë (të jenë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme)</i></p> <p><i>Korridorët mes bankave të jenë me gjerësi të lirë nga pengesat prej 120cm. Hapësira e lirë para derës nga brenda, të ketë diametër 150cm.</i></p> <p><i>Dyshemeja plotëson standartet e përshtatshmërisë</i></p>
<p><b>Tualeti</b></p>	<p>Grupi i tualeteve është i pozicionuar në fund të korridorit dhe përbëhet nga një hapësirë ku është vendosur lavomani si edhe tre tualete me përmasa 150cm x 100cm. Në secilin prej tyre ka vetëm një WC. Dera që akseson grupin e tualeteve nga korridori ka gjerësi 80cm, ndërsa dera e secilit tualet ka gjerësi 60cm. Të gjitha dyert hapen nga brenda.</p> <p>Në gjendjen që janë tualetet janë krejtësisht të papërshtatura për përdorim nga PAK si nga përmasat, nga hapësira e dyerve ashtu edhe nga paisjet.</p>	<p><i>Të ketë së paku një tualet të përshtatur për PAK, sipas standardeve të cilin mund të krijohet i ri ose nga bashkimi i tualeteve ekzistuese. Tuelalet i përshtatur duhet të jetë i paisur me: Derë më gjerësi jo më pak se 85 cm. dhe lehtësisht të hapëshme nga jashtë, mbajtëse pranë clozetit, bidesë dhe lavomanit në lartësi 80 cm. nga dyshemeja, klozeti dhe bideja me formë të përshtatur (mundësisht të varur) i vendosur në lartësi 45cm-50cm nga dyshemeja, lavomani me formë të përshtatur në lartësi 80 cm nga dyshemeja, Tuelalet duhet të jetë i paisur me alarm emergjence me dritë dhe me zë si edhe shenja dalluese gjithashtu. Aksesoret (doreza e derës, prizat etj) duhet të vendosen në lartësi 85-90 cm nga dyshemeja dhe pasqyra në lartësi 100 cm nga dyshemeja. Ngjyra e dyshemesë, paisjeve dhe mureve duhet të krijojnë kontrast për lehtësi orientimi nga PAK me vështirësi në shikim.</i></p>

### Teatri "Zihni Sako"

<p><b>Zona</b></p>	<p><b>Gjetjet/Gjendja ekzistuese</b></p>	<p><b>Kërkesat për nivelin bazë të përshtatshmërisë</b></p>
<p><b>Hyrja kryesore</b></p>	<p>Hyrja kryesore e teatrit arrihet nga rruga publike me shkallët kryesore të përbërë nga dy pjesë, 3 bazamakë 15cm x 35cm dhe tjetra 6 bazamakë 15cm x 35cm., si edhe nga shkalla anësore në të djathtë të përbërë nga dy pjesë, 5 bazamakë 15cm x 35cm dhe tjetra 6 bazamakë 15cm x 35cm.</p> <p>Të dy grupet e shkallëve janë prej gyri të skalitur.</p> <p>Dera kryesore e hyrjes është pjesërisht e plotë dhe pjesërisht me xham, me dy kanata me gjerësi 70cm të cilat hapen nga brenda</p>	<p><i>Të vendosen parrmakë në të dy anët e shkallës dhe parrmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të shkallës në fillim e në fund të saj. Të vendosen shirita orientues në fillim dhe në fund të shkallës.</i></p> <p><i>Vendosja e rampës përbri këtyre shkallëve do të kërkontë sipërfaqe të konsiderueshme për shkak të disnivelet që krijohet nga terreni i pjerrët.</i></p> <p><i>Kanatet e hapëshme duhet të jenë me gjerësi 85-90cm dhe të hapëshme nga jashtë. Në xham të vendosen shenja dalluese.</i></p>

<p><b>Hyrja dytësore</b></p>	<p>Biletaria e teatrit dhe hyrja në sallën (në rrjeshtat e pare) e teatrit arrihen me një shkallë anësore prej guri me 6 bazamakë 16cm x 35cm. Sheshpushimi i shkallës së jashtme para kësaj hyrje të teatrit, vazhdon përtej gjerësisë së shkallës dhe krijon një disnivel prej 80cm me nivelin e sheshit. Sipërfaqja veshëse e shkallës dhe sheshpushimit është jo rrëshqitëse</p> <p>Dera e hyrjes është pjesërisht me dru dhe me xham dhe me 4 kanata të hapëshme nga brenda.</p>	<p><i>Të vendoset rampë në fund të sheshpushimit, përgjatë murit të ndërtesës. Gjatësia e rampës të jetë 1300cm, përsi një sheshpushimi në mes të saj. Gjerësia e rampës duhet të jetë 120cm dhe rampa duhet të jetë e paisur me shirita orientues në fillim dhe mbarim të pjerrësisë për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim. Të vendosen parrmakë në të dy anët e rampës dhe parrmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të saj në fillim e në fund të saj.</i></p> <p><i>Dera duhet të jetë me kanata me gjerësi 85cm - 90cm lehtësisht të hapshme nga jashtë (mundësisht me hapje automatike). Në pjesët e xhamit të vendosen shenjat dalluese.</i></p>
<p><b>Holli &amp; Korridorët</b></p>	<p>Holli akseson korridorët dhe shkallët për të arritur llozhat. Nuk ndodhet panel informues të përshtatur në holl.</p> <p>Korridori ka gjerësi 200cm. Dyshemeja veshëse e hollit dhe korridorit është jo rrëshqitëse</p>	<p><i>Në holl duhet të vendoset panel informacioni i shkruar në brail dhe me drita, për PAK që nuk shikojnë si edhe PAK që nuk dëgjojnë</i></p> <p><i>Në mes të dyshemesë së hollit dhe korridorit të vendosen shirita orientues për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë. Në muret kufizuese të korridorit duhet të vendosen korimano.</i></p>
<p><b>Salla e çfaqjeve</b></p>	<p>Dera e sallës së çfaqjeve hapet nga brenda</p> <p>Niveli ku është vendosur rrjeshti i parë dhe i dytë i karrigeve në sallën e çfaqjes, ku mund të vendoset lehtësisht karrigja me rrota, arrihet me dy bazamakë 17cm x 39cm.</p> <p>Dyshemeja është jo rrëshqitëse</p>	<p><i>Dera e sallës së çfaqjeve duhet të jetë lehtësisht e manovrueshme nga PAK dhe me hapje nga jashtë.</i></p> <p><i>Për kalimin e disnivelit prej 34cm duhet të vendoset një plan i pjerrët portativ, me dru ose metal.</i></p> <p><i>Plotëson standartin</i></p>
<p><b>Tualeti</b></p>	<p>Nuk ka një tualet të përshtatur në këtë ndërtesë</p>	<p><i>Të ketë një tualet të përshtatur për PAK, sipas standarteve. Tualeti i përshtatur duhet të jetë i paisur me: Derë më gjerësi jo më pak se 85 cm. dhe lehtësisht të hapëshme nga jashtë, mbajtëse pranë clozetit, bidesë dhe lavomanit në lartësi 80 cm. nga dyshemeja, klozeti dhe bideja me formë të përshtatur (mundësisht të varur) i vendosur në lartësi 45cm-50cm nga dyshemeja, lavomani me formë të përshtatur në lartësi 80 cm nga dyshemeja, Tualeti duhet të jetë i paisur me alarm emergjence me dritë dhe me zë si edhe shenja dalluese gjithashtu. Aksesorët (doreza e derës, prizat etj) duhet të vendosen në lartësi 85-90 cm nga dyshemeja dhe pasqyra në lartësi 100 cm nga dyshemeja. Ngjyra e dyshemesë, paisjeve dhe mureve duhet të krijojnë kontrast për lehtësi orientimi nga PAK me vështirësi në shikim.</i></p>

### Shkolla 9-vjeçare “Koto Hoxhi”

<p><b>Zona</b></p>	<p><b>Gjetjet/Gjendja ekzistuese</b></p>	<p><b>Kërkesat për nivelin bazë të përshtatshmërisë</b></p>
--------------------	--	---

<b>Oborri</b>	Oborri i shkollës arrihet në dy drejtime, nga dy rrugë të ndryshme. Porta kryesore ka disnivel me sheshin/terrenet sportive para hyrjes në mjediset e brendshme të shkollës, i cili kalohet me disa shkallë zbritëse. Porta nga mbrapa akseson oborrin/terrenin sportiv me një plan të pjerrët direkt mbas portës. Të dy sheshet.terrenet sportive kanë disnivel që kalohet me 3 ngjitje shkallësh. Në shtresën veshëse të oborrit mungojnë shiritat orientues për të lehtësuar aksesin e PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim	<i>Në shtresën veshëse të oborrit duhet të vendosen shirita orientues për PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim për të arritur hyrjen në mjediset e brendshme dhe terrenet sportive</i>
<b>Hyrja kryesore</b>	Hyrja për në mjediset e brendshme të shkollës arrihet me dy bazamakë prej rreth 30cm-35cm + 10cm-15cm.  Dera kryesore e hyrjes është me dy kanata	<i>Të vendoset rampë në hyrje për kalimin e disnivelit. Gjatësia e rampës të jetë 500cm. Gjerësia e rampës duhet të jetë 120cm dhe rampa duhet të jetë e paisur me shirita orientues në fillim dhe mbarim të pjerrësisë për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim. Të vendosen parmakë në të dy anët e rampës dhe parmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të saj në fillim e në fund të saj.  Kanata duhet të ketë gjerësi 85cm - 90cm dhe të jenë lehtësisht të hapshme nga jashtë (mundësisht me hapje automatike).</i>
<b>Holli &amp; Korridoret</b>	Holli akseson korridoret e klasave dhe shkallët për të arritur katet e sipërme.  Korridoret kanë gjerësi 180cm.	<i>Në holl duhet të vendoset panel informacioni i shkruar në brail dhe me drita, për PAK që nuk shikojnë si edhe PAK që nuk dëgjojnë  Në mes të dyshemesë së hollit dhe korridoreve të vendosen shirita orientues me degëzime në klasa dhe në grupin e tualeteve, për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë. Në muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.</i>
<b>Klasat</b>	Dyert e klasave janë të hapëshme nga brenda.	<i>Dyert duhet të jenë me gjerësi 85-90cm, lehtësisht të manovrueshme nga PAK dhe me hapje nga jashtë.  Së paku 15% e bankave të plotësojnë standartet e përshtatshmërisë. (të jenë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme)  Korridoret mes bankave të jenë me gjerësi të lirë nga pengesat prej 120cm. Hapësira e lirë para derës nga brenda, të ketë diametër 150cm. Dyshemeja plotëson standartet e përshtatshmërisë</i>
<b>Tualeti</b>	Nga informacioni që siguroam, tualetet nuk janë të përshtatur për PAK.	<i>Të ketë së paku një tualet të përshtatur për PAK, sipas standarteve Tuelalet i përshtatur duhet të jetë i paisur me: Derë më gjerësi jo më pak se 85 cm. dhe lehtësisht të hapëshme nga jashtë, mbajtëse pranë clozetit, bidesë dhe lavomanit në lartësi 80 cm. nga dyshemeja, klozeti dhe bideja me formë të përshtatur (mundësisht të varur) i vendosur në lartësi 45cm-50cm nga dyshemeja, lavomani me formë të përshtatur në lartësi 80 cm nga dyshemeja, Tuelalet duhet të jetë i paisur me alarm emergjence me dritë dhe me zë si edhe shenja</i>

		dalluese gjithashtu. Aksesorët (doreza e derës, prizat etj) duhet të vendosen në lartësi 85-90 cm nga dyshemeja dhe pasqyra në lartësi 100 cm nga dyshemeja. Ngjyra e dyshemesë, paisjeve dhe mureve duhet të krijojnë kontrast për lehtësi orientimi nga PAK me vështirësi në shikim.
<b>Universiteti “Eqrem Çabej”/Fakulteti i Letërsisë</b>		
<b>Zona</b>	<b>Gjetjet/Gjendja ekzistuese</b>	<b>Kërkesat për nivelin bazë të përshtatshmërisë</b>
<b>Parkimi</b>	Sheshi para fakultetit arrihet direkt nga rruga nga mbrapa. Nuk ka një vendparkimi për PAK në këtë shesh.	Të parashikohet së paku një vend parkimi për PAK sipas standartit, në sheshin para hyrjes në fakultet.
<b>Hyrja kryesore</b>	<p>Hyrja kryesore e fakultetit arrihet me 8 bazamakë shkalle prej 17cm x 30cm. duke krijuar një disnivel prej 144cm nga niveli i sheshit para objektit.</p> <p>Përbri shkallës është vendosur një rampë për arritjen e hyrjes e cila është e paisur me parmakë, ndonëse nuk i plotëson të gjitha standartet.</p> <p>Shtresa veshëse e rampës është jo rrëshqitëse.</p> <p>Dera kryesore e hyrjes është pjesërisht e plotë dhe pjesërisht me xham, me kanata të cilat hapen nga brenda</p>	<p>Të vendosen parmakë në të dy anët e shkallës dhe parmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të shkallës në fillim e në fund të saj. Të vendosen shirita orientues në fillim dhe në fund të shkallës, si edhe shirita abrazivë në cdo bazamak të saj.</p> <p>Të korrigjohet rampa. Gjatësia e rampës të jetë 2400cm, përsi dy sheshpushime në cdo 600cm. Gjerësia e rampës duhet të jetë 120cm dhe rampa duhet të jetë e paisur me shirita orientues në fillim dhe mbarim të pjerrësisë për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim. Të vendosen parmakë në të dy anët e rampës dhe parmakët të zgjaten 30 cm jashtë konturit të saj në fillim e në fund të saj.</p> <p>Dera duhet të jetë me kanata me gjerësi 85cm - 90cm lehtësisht të manovrueshme nga PAK (mundësisht me hapje automatike) dhe me hapje nga jashtë. Xhami të fillojë në lartësi 40cm nga niveli i dyshemesë. Në pjesët e xhamit të vendosen shenjatat dalluese.</p>
<b>Holli &amp; Korridoret</b>	Holli akseson korridoret dhe shkallët për të arritur katet e sipërme.	<p>Në holl duhet të vendoset panel informacioni i shkruar në brail dhe me drita, për PAK që nuk shikojnë si edhe PAK që nuk dëgjojnë</p> <p>Në mes të dyshemesë së hollit dhe korridoreve të vendosen shirita orientues me degëzime në mjediset më të frekuentuara dhe në grupin e tualeteve, për lehtësi të lëvizjes për PAK që nuk shikojnë. Në muret kufizuese të korridoreve duhet të vendosen korimano.</p>

<p><b>Auditoret</b></p>		<p><i>Dyert duhet të jenë me gjerësi 85-90cm, lehtësisht të manovrueshme nga PAK dhe me hapje nga jashtë.</i></p> <p><i>Së paku 15% e të gjitha bankave të plotësojnë standartet e përshtatshmërisë. (të jenë të lira nga pengesat në pjesën e poshtme)</i></p> <p><i>Korridoret mes bankave të jenë me gjerësi të lirë nga pengesat prej 120cm. Hapësira e lirë para derës nga brenda, të ketë diametër 150cm.</i></p> <p><i>Dyshemeja të jetë jo rrëshqitëse</i></p>
<p><b>Tualeti</b></p>	<p>Nuk ka tualet të përshtatur për PAK.</p>	<p><i>Të ketë së paku një tualet të përshtatur për PAK, sipas standarteve. Tualeti i përshtatur duhet të jetë i paisur me: Derë më gjerësi jo më pak se 85 cm. dhe lehtësisht të hapëshme nga jashtë, mbajtëse pranë clozetit, bidesë dhe lavomanit në lartësi 80 cm. nga dyshemeja, klozeti dhe bideja me formë të përshtatur (mundësisht të varur) i vendosur në lartësi 45cm-50cm nga dyshemeja, lavomani me formë të përshtatur në lartësi 80 cm nga dyshemeja, Tualeti duhet të jetë i paisur me alarm emergjence me dritë dhe me zë si edhe shenja dalluese gjithashtu. Aksesorët (doreza e derës, prizat etj) duhet të vendosen në lartësi 85-90 cm nga dyshemeja dhe pasqyra në lartësi 100 cm nga dyshemeja. Ngjyra e dyshemesë, paisjeve dhe mureve duhet të krijojnë kontrast për lehtësi orientimi nga PAK me vështirësi në shikim.</i></p>